

shpallje nr. 19.06.2020

poziv na mjesto nr. 04-07-2020



Në bazë të nenit 113 paragrafit 1 dhe 3 të Ligjit mbi vetëqeverisjes lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 02/18, 34/19, 038/20), e në lidhje me nenin 7 të Vendimit mbi organizimin mbi mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 026/19, 030/19, 08/20) dhe Vendimit mbi fillimin e procedurave për plotësimin e vendit të punës, numër 10-032/20-5753 prej më 18.06.2020, Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burimet njerëzore, shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM

për nevojat e Shërbimit të policisë Komunale dhe inspektionit Komunal të Komunës së Tuzit

1. Referent/e i/e lartë- polic/e komunal/e

- Ekzekutues: 4, në kohë të pacaktuar
- Niveli i IV-1 i kualifikimit shkollor të përgjithshëm ose drejtimit teknik
- së paku një vit përvojë pune
- provimi profesional për punë në organet shtetërore
- provimi i kryer mbi aftësinë profesionale për kryerjen e punëve të policisë komunale
- provimi i patent shoferit për kategorinë B.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- formulari i paraqitjes për vendin e lire të punës (Formularin e paraqitjes për vendin e lirë të punës kandidatët mund ta nxjerrin në web faqen e Komunës së Tuzit www.tuzi.org.me ose drejtpërdrejt në arkivin e Komunës së Tuzit),
- Curriculum Vitae – CV,
- fotokopja e letërnjoftimit biometrik,
- diplomë ose vërtetim mbi përfundimin e nivelit dhe llojit të arsimit
- vërtetimin e gjyqit kompetent se kundër kandidatit –es nuk zhvillohet procedure penale sipas detyrës zyrtare,
- dëshmi (vërtetim/miratim) mbi përvojën e kërkuar të punës,
- vërtetim mbi provimin e dhënë profesional për punë në organet shtetërore.

Kandidatët mund tia dorëzojnë kopjen e dokumentacionit të lartpërmendur Zyrës për burimet njerëzore (Në tekstin e mëtejme, Zyrës), përderisa origjinalin janë të obliguar tia japin në shikim zyrtarit të autorizuar të Zyrës për realizimin e shpalljes.

Bashkëngjitur me fletëparaqitje në konkurs është e nevojshme të dorëzohet specifikimi i dokumentacionit shpallës në të cilin është e domosdoshme të theksohet numri i dokumentit, data e lëshimit dhe institucioni që ka lëshuar dokumentin i cili dorëzohet në Zyrën për burime njerëzore (Formulari i paraqitjes me vështrim të dokumentacionit mund të merret në faqen e internetit të Komunës së Tuzit, www.tuzi.org.me ose drejtpërsëdrejti në arkivin e Komunës së Tuzi).

Në konkurs të brendshëm mund të paraqitet zyrtari lokal i cili ka lidh marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, inspektori kryesorë dhe personi zyrtarë kryesorë i autorizuar, personi nga neni 128 paragrafi 2 i Ligjit mbi vetëqeverisje lokale ("Fleta zyrtare e MZ", nr.02/18, 34/19, 038/20) si dhe personi të cilit i ka pushuar mandati me skadimin e mandatit, në kërkesë personale, me shkëputjen e organit të administratës lokale, shërbimit profesional, gjegjësisht shërbimit të veçantë ose pjesës së punëve që nuk ndërmerr organi tjetër ose shërbimi ose nëse vendi i punës së tij do të ndërpritet me sjelljen e aktit të ri ose ndryshimin e atij ekzistues mbi sistematizimin dhe organizimin e brendshëm.

Me organin shtetëror nuk mund të lidh vend pune personi i cili është përdorues i të drejtës në pension, në pajtim me ligjin.

Zyrtari lokal i cili është në punë të provës nuk ka të drejtë të paraqitet në konkurs të brendshëm.

Verifikimi i dijes, aftësisë, kompetencave dhe shkathtësive, varësisht prej kategorisë së vendit të punës do të bëhet në pajtim me nenin 115 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", numër 02/18, 34/19, 038/20) dhe me Rregullore për kriteret dhe metodën më të afërt të kryerjes së vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave dhe aftësive për të punuar në organet shtetërore ("Fleta Zyrtare e MZ", numër 50/18).

Testimi në formë të shkruar përbëhet nga pjesa teorike dhe ajo praktike dhe nënkupton hartimin e testit të shkruar.

Verifikimi i dijes së daktilografisë, informatikës ose gjuhës së huaj bëhet në pajtim me rregullat, gjegjësisht standardet në këto fusha.

Testi i shkruar hartohet në formë elektronike, me shifër.

Mbi datën, vendin, dhe mënyrën e verifikimit, të kandidatëve nga lista, kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e shpalljes publike do të jenë të njoftuar përmes ueb faqes së Komunës së Tuzit, më së largu pesë ditë para ditës së verifikimit.

Dokumentacioni i kërkuar është i nevojshëm të dorëzohet në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit publik në zarf të mbyllur (në të cilin është e nevojshme të shkruhet: emri dhe mbiemri, adresa, kontakt telefoni, emri i organit dhe vendi i punës) në adresën:

Komuna e Tuzit

Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burime njerëzore

Me shënim: për Konkurs të brendshëm për nevoja të Shërbimit të policisë komunale dhe inspektionit komunal të Komunës së Tuzit

Kontakt tel: +38220875167;

**SEKRETARE,
Marina Ujkaj**

